



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:135817  
Datë: 24.05.2023  
Numri i dokumentit: 04317514

**PA1.nr.1058/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit L. G. , nga K., për shkak të veprës penale në Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 dhe nënpar.1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, P.nr.144/2021, datë 14.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.05.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, P.nr.144/2021, datë 14.06.2022, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, me aktgjykimin, P.nr.144/2021, datë 14.06.2022, të akuzuarin L. G. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 dhe nënpar.1.4, të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilën shumë është obliguar që të e paguaj brenda afatit kohor në kohëzgjatje prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku 1 (një) ditë burgim do ti llogaritet në 20 (njëzet) € të gjobës. Lirohet i akuzuari nga shpenzimet, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike. Udhëzohet e dëmtuara, që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen të ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.1096/2022 të datës 21.07.2022 ka propozuar të aprovohet ankesa e prokurorit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

**- Ankesa është e pabazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi dënimin duke pretenduar, që gjykata me aktgjykimin e ankimuar nuk ka vepruar drejtë duke i mbivlerësuar rrethanat lehtësuese, konsiderojmë se gjykata është dashur të merr për bazë si rrethanë rënduese shkallën e përgjegjësisë penale dhe ta vlerësoj drejtë dënimin që i është shkaktuar të dëmtuarës – bashkëshortes së tij si dhe me dashjen e të akuzuarit i cili ishte i vetëdijshëm për veprimet e tij të kundërligjshme, ku i njëjti fillimisht e godet me shuplaka në pjesët e pasme të kokës e pastaj e kafshon në krahun e majtë të cilës i shkakton lëndime trupore, po ashtu është dashur të merret parasysh edhe sjellja e mëparshme e të akuzuarit i cili në mënyrë sistematike ka ushtruar dhunë fizike dhe psikike ndaj të njëjtës por rasti nuk është raportuar nga e dëmtuara duke shpresuar se do të bëhet mirë dhe për hire të fëmijëve ka tejkalluar çdo problem edhe pse ka qenë e sëmurë. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen të ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e prokurorit, për anulimin e aktgjykimit, janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e cila do ta arsyetonte për anulimin e aktgjykimit, ndaj të akuzuarit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit e duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, konform të dispozitës së nenit

69, dhe 70 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, e që kjo rrethanë ndërlihet me rrethanat tjera, si dhe fakt se i njëjti është penduar për veprën e kryer penale, i akuzuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, i ka premtuar gjykatës se nuk do ta përsëris më veprën penale si dhe i njëjti tani jeton me të dëmtuarën – bashkëshorten e tij, ndërsa gjykata si rrethanë rënduese gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale. Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënim sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me këtë dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, si dhe duke pas parasysh faktin se në ankesën e prokurorit nuk theksohet ndonjë rrethanë e re rënduese e cila nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe e cila do të kishte me pas ndikim në anulimin e aktgjykimit, andaj sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate të gjitha këto japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar si dhe dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i nevojshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

### **Departamenti i Përgjithshëm**

PA1.nr.1058/22, më datë 12.05.2023

**Zyrtarja ligjore:**

Rrezarta Bala

---

**Kryetar i kolegjit:**

Beqir Kalludra

---

**Anëtarët e kolegjit:**

Skender Çoçaj

---

Kadrije Goga Lubishtani

---